




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**  
Nr.01-060/01-1536/20 datë:20.01.2020



Npi – 01/37 datë: 30.01.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 30.01.2020 është nxjerrë ky:

**E K STRAKT**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -I- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**

E mbajtur më: 30.01.2020, e (enjte) në ora 10.<sup>oo</sup> h. në sallën e re të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Medina Brahaj, Perparim Ramusa, Shefki Dauti, Herolind Selmani, Reshat Mujotà, Arbresha Syla, Milot Deliu, Fatmire Ferati, Naim Zejna, Skender Hyseni, Zarife Rexhaj, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, Marigona Pajaziti, Fehmi Hysenaj, Adelina Beqaj, Isak Muslija, Diarta Vishesella, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli, Drejtorët; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Ardita Ndrecaj; Zyrtari për barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Zyrtari Ligjor z.Lulzim Muharremi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Përfaqësuesi i OSBE-së, z.Mefail Mustafa; Përfaqësuesit e KFOR-it me përkthyesin; Praktikantja znj.Fortuna Fazliu; Zyrtarët e IT-së Gazmend Ademaj dhe Shpëtim Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.11.2019, dhe 23.12.2019
2. Pyetje – Përgjigje,
3. Propozim-vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2020 (Pas diskutimit publik).
4. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2020,
5. Raport i Punës së Kuvendit për vitin 2019,
6. Raport i aktiviteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019,
7. Informatë për Obligimet e Komunës nga Agjenda Evropiane, (MSA)
8. Informatë e përgjithshme nga DKRS-së,
9. Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021 (Pas diskutimit publik)
10. Propozim-Vendim për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime. (Pikë shtesë)

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, propozoj që të futet edhe një pikë shtesë e rendit të ditës "Propozim-Vendim për dhënien veturës komunale Stacionit të Policisë në Shtime".

Para se të hapi mbledhjen ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje për nderë të ramjes në detyrë të Policisë të Kosovës. (Lavdi) Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z. Ruzhdi Jashari;** Përshëndetje, fillimisht e uroj drejtoreshën e re të zgjedhur, znj. Agime Roshaj në sektorin e arsimit. Ne pajtohemi me rendin e ditës por edhe me pikën shtesë që u propozua edhe pse për këtë pikë kemi disa vërejtje, sepse ne e dimë që Policia nuk kanë as sigurime shëndetësore e as kushte të mira për punë, e jo ne tash të qohemi e të ua japim veturën më të keqe të komunës, unë jam që në opsion të futen të gjitha veturat e Komunës edhe ajo e Kryetarit. kështu që ne e mbështesim propozimin por për një veturë të kompletuar teknikisht.

**z. Shefki Dauti;** Përshëndetje, pajtohemi me rendin e ditës, ndërsa për pikën shtesë do të diskutojmë pasi që kjo pikë të aprovohet.

**z. Naim Zejna;** Përshëndetje, urime për zgjedhjen e znj. Agime Roshaj në postin e drejtorit të arsimit. Unë realisht pajtohem me pikën shtesë por jam që të shikojmë mos ndoshta dikund tjetër kemi nevojë shumë më të madhe.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi rendin e ditës me pikën shtesë: "Propozim-Vendim për dhënien veturës komunale Stacionit të Policisë në Shtime".**

#### Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.11.2019, dhe 23.12.2019

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z. Ruzhdi Jashari;** Procesverbali është bukur problematik, sepse nuk mund të përfshihen të gjitha diskutimet por disa më kryesore. Te pika e dyte kam pas fyerje nga N. Ismajli, kur drejtohet kah delegatet kryesisht të PDK-se duke ju thënë "Mos e dëgjoni këtë (Ruzhdin) sepse tash qytetaret votojnë ndryshe dhe as votat e familjes nuk ti japin ty, duke aludua në familjen Jashari" dhe ndërhyrjen time se "ky veprim i juaji është në stilin përçaj e sundo", kjo pra nuk është përfshirë në procesverbal e që kërkoj që kjo të përfshihen këto sjellje të tij.

**z. Skender Hyseni;** Kur kam bërë pyetje në mbledhjen e kaluar për Trotuarin në fshatin Muzeqinë është shkruar që të vazhdohet trotuari, unë nuk kam thënë të vazhdohet trotuari, por kam thënë të vazhdohet me projekte e në këtë kuadër edhe me projektin e rregullimit të trotuarit në fshatin Muzeqinë.

**\* Kuvendi i Komunës, me 16 vota "Për" dhe me 2 vota "Abstenim" aprovoi të dy ekstrakt procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 26.11.2019, dhe 23.12.2019.**

#### Pika 2

##### Pyetje – Përgjigje

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z. Skender Hyseni;** Unë po pyes për një objekt që është në Muzeqinë e që është ndërtuar nga Komuna, në të cilin nuk punohet asgjë, a është menduar se çka të bëhet me këtë objekt, sepse ai dita ditës vetëm po shkatërrohet?

**z. Reshat Mujota;** Pyetje për DKA-në, sa është numri i nxënësve të fshatit Llanisht të cilët i ndjekin mësimet në shkollën e fshatit Petrovë? Pyetja tjetër është se sa është numri i nxënësve me nevoja të veçanta dhe sa plotësohen nevojat e tyre? Pyetje për DSHP-në, nga kush po menaxhohen Parkingjet Publike në Shtime? Pyetje për DSHMS-në, sa dhe far shërbime po kryhen në QKMF-ë sa i përket Stomatologjisë?

**z. Fehmi Hysenaj;** Përshëndetje, Uroj znj. Agime Roshaj zgjedhjen në postin e Drejtoreshës së Arsimit.

Pyetjet që i kam bërë më parë nuk kam marrë përgjigje. Kërkoj që të epen përgjigje në pyetjet që i kam bërë më parë. Kërkoj nga DSHP-ë që të ndërmerr masa për zvogëlimin e shpejtësisë së automjeteve në rrugën “Afrim Selmani” sepse në këtë rrugë nuk ka as barriera e asnjë lloj shenje të komunikacionit për zvogëlimin e shpejtësisë?

**z.Besnik Seferi;** Kam pyetje për DSHP-në, ditëve të fundit po shtrihen disa kablllo a është në dijeni Komuna për këto kablllo që po vendosen? Pyetje për DSHP-në, kemi vërejtur se shumë shenja të komunikacionit janë rrëzuar për tokë çka do të bëhet me to a do të rregullohen? Pyetje për DSHMS-në, a është në rregull aparatura e Ultrazërit në QKMF-ë, dhe pse duhet me pritë me termin aty? Unë e uroj zgjedhjen e znj.Agime Roshaj drejtoreshë e DKA-së, dhe kam një pyetje se çka do të ndërmarrë për përmirësimin e cilësisë në arsim? dhe pyetja tjetër a ka mungesë të stafit ?

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, Uroj znj.Agime Roshaj zgjedhjen në postin e Drejtoreshës së Arsimit. Në mbledhjen e kaluar kam bërë dy pyetje, njëra ka qenë për fshatin Pjetërshticë, ndërsa pyetja e dytë ka qenë për fshatin Petrovë, ku kam thënë se ujë ka mjaftueshëm por ka edhe mbeturina. unë prap po e përsëris kërkesën time për ndërtimin e një shkollë të re në fshatin Petrovë?

**z.Perparim Ramusa;** Përshëndetje, Uroj znj.Agime Roshaj zgjedhjen në postin e Drejtoreshës së Arsimit. Unë kam një pyetje jo për ekzekutivin por për Kuvendin , e kemi formua një komision për verifikimin e banesave, kam dëshirë ta di a është tubuar ndonjë herë ky komision dhe deri ku kanë ardhur?

**z.Muhamet Ademaj;** Përshëndetje, Uroj znj.Agime Roshaj zgjedhjen në postin e Drejtoreshës së Arsimit, e uroj edhe ish drejtorin për punën e bërë. Kam pyetje për DKA-n, e para çka do të ndërmerrni për zvogëlimin e peshës së çantave për nxënës, a ka mundësi që të bëhen rafta në shkollë ? dhe pyetja e dytë i përket subjekteve afariste a ka mundësi që një ditë të jetë ditë pushimi?

**z.Milot Deliu;** Kam pyetje për DSHP z.Halil Halilit – A është shqyrtuar kërkesa e z.Tahir Rushitit nga fshati Rashincë i cili ne emër te 5 familjeve vazhdimisht kërkon qe ti mundësohet kyçja ne rrjetin e kanalizimit. Sepse rrjeti i tij përfundon afër rezervuarve te ujësjellësit dhe është një rrezik potencial i kontaminimit te ujit te pijshëm per te gjithë banoret ? Pyetje për DSHP-në, ne fshatin Carralevë tash e disa muaj është shkatërruar trotuari ne rrugën kryesore, ky trotuar i montuar nga materiali i hekurt, është ne një lartësi përafërsisht mbi 3 metra dhe përbën një rrezik fatal per fëmijët, nxënësit, dhe gjithë banoret të cilët kalojnë në të vetmen rruge për në shkollë. Kur do te merrni masa per rregullimin e këtij problemi? Pyetje për Zyrtarin Ligjor z.Lulzim Muharremi, Meqenëse ne REGULLOREN E PUNES SE KUVENDIT DHE KOMITETEVE te Neni 3 por edhe në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.02/2015. Te Neni 5.3 thuhet që ftesa, rendi i ditës dhe materialet duhet te dërgohen 7 dite pune para mbajtjes se mbledhjes. Ndërsa ne e kemi pranuar më datën, 29 të këtij muaji vetëm një ditë para mbledhjes si material shtesë një Rekomandim nga zyra e Kryetarit po ashtu edhe procesverbalin e mbledhjes se muajit te kaluar. Ky fakt a përbën shkelje te rregullores dhe Udhëzimit Administrativ ?

**z.Ruzhdi Jashari;** Pyetjet të adresuara në ekzekutiv për mos me humbë kohë janë këto: Te çështja e funksionalizimit të deponisë “Pastërtia” ky vendim është i Kuvendit të Komunës menjëherë pas konstatimit të asamblesë që faktikisht nuk ka funksionalitet. Më së pari pse nuk ka? Një raport nga DSHP-ë për çështjen e pastërtisë ku është niveli i pastërtisë? Pyetje për DKA-në, Orët në arsim pse janë shkurtuar në disa shkollë fillore a është justifikimi është për shkak të ngrohjes a ka pasur raste që një ditë ose dy nuk kanë qenë nxënësit në shkollë? Cilat janë masat për luftimin e drogës?

**znj.Arbresha Sylja;** Përshëndetje, Uroj znj.Agime Roshaj zgjedhjen në postin e Drejtoreshës së Arsimit, edhe për faktin se e kemi edhe një drejtoreshë femër, por edhe për faktin se është e përgatitur për një post të tillë. Sa i përket pyetjeve unë kësaj radhe nuk kam ndonjë pyetje.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, kemi bërë pyetje por që pyetjet nuk po adresohen. Në rrugën “ Wiliam Wollker” po zhvillohet shpejtësi e madhe me automjete për këtë arsye kërkoj që në këtë rrugë të vendosen barriera? Në rrugën “Ibrahim Rugova” më parë kam kërkuar rregullimin e trotuarit gjë që nuk është bërë pyetjen time po e përsëris? Pse ka dështuar asfaltimi i rrugës për te shpella e Pjetërshticës?

Pyetja tjetër për inspektorët çka do të ndërmerret për ndalimin e pirjes së duhanit nëpër lokale por edhe nëpër zyre të Komunës ?

**z.Naim Zejna;** Në një numër të madh të pyetjeve që i kemi bërë nuk kemi marr përgjigjeje. Me këtë rast dua që ta uroj Valentinën për lindjen e djalit në emër të subjektit politik të LDK-së. Kërkesa ime është që materiali mos me na ardhur me vonesë.

**z.Shefki Dauti;** Edhe unë e uroj Valentinën për lindjen e djalit. Pyetje për ekzekutivin te ura e madhe trotuari është bërë vetëm në anën e djathtë, unë po pyes a do të bëhet trotuari edhe në anën e majtë sepse konsideroj se është e domosdoshme?

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Edhe unë e shfrytëzoj rastin që në emër të Kuvendit fillimisht ta uroj znj Agime Roshaj për zgjedhjen në postin e drejtoreshës së arsimit. Po ashtu e uroj edhe Valentina Halili- Ferati për lindjen e djalit.

### Pika 3

#### Propozim-vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit dhe KPF-së për vitin 2020 (Pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Kemi organizuar diskutim publik ashtu siç ka marrë vendim Kuvendi për Planin e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, mirëpo në këtë mbledhje ka qenë vetëm znj.Fatmire Ferati dhe znj.Diarta Vishesella. Nuk është mirë që të merret vendim për diskutim publik e pastaj kur vjen koha mos me marrë pjesë askush. Sa i përket Komisionit në mbledhje ka qenë vetëm z.Naim Zejna. Përkundër kësaj ne kemi nxjerrë disa rekomandime të cilat janë të inkorporuar në draft dokumentin e planit. Tani ju këtë dokument e keni marrë me ndryshimet që janë propozuar. Disa ndryshime janë propozuar edhe nga znj.Ardita Ndrecaj të cilat po ashtu janë inkorporuar në dokument. Unë po besoj që dokumentin e keni lexuar dhe tani mund ta aprovojme, por paraprakisht po e lexoj edhe rekomandimin e KPF-s. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arbresha Syla;** Sa i përket diskutimit publik ne edhe ne fillim kemi qenë kundër por jo për diçka tjetër por vetëm se konsideroj se është punë e Kuvendit. Unë mendoj se me rendësi është njoftimi i jonë për qytetarët si dhe që të ju ofrojmë atyre mundësinë me qëllim që të kontribuojmë në realizimin planit të punës të Kuvendit.

**znj.Fatmire Ferati;** Zakonisht ne kritikojmë për sa i përket debateve publike ndërkaq që vet nuk marrim pjesë. Është marr vendim për diskutim publikë edhe pse dikush ka qenë kundër mirëpo debati duhet të mbahet. Ne do të punojmë tërë vitin mbi bazën e këti plani. Ne si anëtarët Kuvendit duhet të marrim pjesë me qëllim që me përçuar një mesazh të mirë te qytetari. Në diskutim publikë është dashur të marrin pjesë edhe anëtarët e komisionit. Në këtë draft unë besoj që janë përfshi të gjitha aktivitetet, prandaj propozoj që ta votojmë.

**z.Ruzhdi Jashati;** Çështja e dështimit të debateve është kryekëput pa aftësi e ekzekutivit për ta organizuar debatin publikë. Ne kemi thënë se nuk ka nevojë për debat publikë. Propozoj që në plan të punës të përfshihet edhe zyra e auditimit.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Po zyra e auditorit është e përfshirë në plan në muajin korrik.

**z.Ruzhdi Jashati;** Thash se duhet të shtohet edhe çështja e aludimit të brendshëm në planin e punës së Kuvendit, nuk është pak me i marr 1200€ rrogë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Ne nuk kemi qenë pjesë e vendimit por konsideroj se ky planë është i lidhur me planin e ekzekutivit. Sipas nenit 6 të U.A. E parasheh qartë që plano duhet të nxirret në diskutim publikë. Kriteret për diskutim duhet të respektohen. E përgëzoj punën e komisionit sepse më mirë me një plan sesa pa lanë fare. Unë propozoj që në muajin gusht ta kemi një informatë nga arsimit ku do të pasqyrohej aspekti i përgatitjeve për fillimin e vitit shkollorë. Po ashtu propozoj që në plan ta kemi edhe një pikë për sa i përket vizitave të Kuvendit jashtë Kosovë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Në muajin dhjetorë kemi edhe një pikë për auditorin e jashtëm ndërsa sa i përket vizitave të Kuvendit jashtë Kosovës, unë po përpiqem që ta shikoj këtë mundësi.

**z.Muhamet Ademaj;** Po bëhet fjalë për një planë të punës mbi bazën e të cilit do të punojmë gjatë vitit 2020. Unë propozoj që përveç mbledhjeve të rregullta në planë të fusim edhe 2 mbledhje solemne.

**z.Perparim Ramusa;** Është me rëndëso që plani është përpiluar mirë prandaj unë jam që të votohet.

**z.Rexhep Gashi;** Edhe unë e përkrahu këtë planë. Sa i përket diskutimit publikë unë e shoh më shumë të mirë për qytetarët se sa për anëtarët e Kuvendit.

**z.Besnik Seferi;** Unë kam qenë pjesë e komisionit, mendoj se ne duhet me u ndal te propozimet konkrete. Unë propozoj të kenë një pikë shtesë “Plani i punës së Prokurimit” në muajin maj.

**z.Muhadin Halili, drejtor i Prokurimit;** Përsëritet unë desha të jap vetëm një informacion lidhur me planifikimin e Prokurimit i cili bëhet 15 ditë pasi të aprovohet buxheti i Kosovës.

**z.Besnik Seferi;** Atëherë le të mbetet kështu si tha drejtori, por unë po kërkoj që ta kemi një plan nga Prokurimi i cili mund të jetë edhe në muajin mars.

**z.Isak Muslija;** Unë po e tërheq fjalën sepse po bëhet tollovi me diskutime të pa vlera .

**z.Reshat Mujota;** Sa i përket planit të punës unë po lidhem te mos pjesëmarrja në diskutim publikë edhe pse unë kam marr pjesë por ne kemi pas edhe një komision i cili ka punuar në draftin e këtij plani. Ne i kemi pas mundësitë që të japim propozimet tona veç e veç disa nga propozimet veç janë të inkuorporuar në planë mirëpo disa koleg po shihet qartë se nuk e kanë lexuar këtë dokument prandaj po i përsërisin propozimet.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Fehmiu propozoi që në muajin gusht të kemi të planifikuar një informatë për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë .

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës, me 13 vota ”Për” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi propozimin e z.Fehmi Hysenaj që në muajin gusht të kemi të planifikuar një informatë për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollorë .

\* Kuvendi i Komunës, me 11 vota ”Për” dhe me 4 vota “Abstenim” aprovoi propozimin që plani i prokurimit të inkuorporohet në planin e Kuvendit sipas propozimit të z.Besnik Seferit në muajin Maj.

**z.Ruzhdi Jashari;** Pika e Dhjetorit për auditorin propozoj që të zhvendoset në muajin Korrik.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Propozimi i Fehmiut për vizitë studimore të mbetet në muajin Maj.

\* Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi propozimin që vizita studimore të inkuorporohet në planë në muajin Maj.

\* Kuvendi i Komunës, me 05 vota ”Për” dhe me 10 vota “Kundër” nuk e aprovoi propozimin e Ruzhdi Jasharit që pika e Dhjetorit për auditorin të zhvendoset në muajin Korrik.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 30.01.2020, unanimisht aprovoi Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2020 me propozimet e aprovuara.

#### Pika 4

##### Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2020

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë jam që të respektohet ky orar.

**z.Naim Zejna;** Këtë shqetësim e kam ngrit edhe në KPF-ë me arsyetimin se kam kërkuar që të kemi një diferencë më të madhe kohore në mes të mbledhjeve të KK dhe KPF së paku për një javë.

**z.Perparim Ramusa;** Unë mendoj se duhet të votohet orari i mbledhjeve, diferenca kohore e propozuar nga Naimi nuk është bindëse unë jam i bindur se kjo diferencë kohore mjafton prandaj unë propozoj që të aprovohet kështu si është.

**z.Ruzhdi Jashari;** Ne e mbështesim propozimin dhe kërkojmë që të përkrahet ky orar i mbledhjeve për vitin 2020.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 17 vota "Për" dhe me 2 vota "Abstenim" aprovoi orarin e mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2020.**

#### Pika 5

##### Raport i Punës së Kuvendit për vitin 2019

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Prezantoi raportin para delegatëve duke lexuar, dhe në vazhdim tha se raportin e keni marrë të shkruar me kohë, kështu që unë po hapi diskutimin për këtë pikë. (Shih dokumentin)

**z.Perparim Ramusa;** Faleminderit për raportin, është një raport real. Për mua brengosës është fakti se në këtë raport nuk është paraqitur puna e Komiteteve, pra kjo është vërejtja ime, por sidoqoftë unë jam që ky raport të kalojë.

**z.Ruzhdi Jashari;** Raporti nuk e ka tanguar aspektin e raporteve të Komiteteve të tjera. Po ashtu edhe puna e Komisioneve të formuara nga Kuvendi duhet të paraqitet në raportin e punës së Kuvendit. Po ashtu në raport mungon aspekti i punës së subjekteve politike në punën e Kuvendit. kështu që ky raport nuk është në përputhje të plotë me Ligjin.

**z.Muhamet Ademaj;** Kuvendi ka bërë punë të mirë, uroj që Kuvendi edhe gjatë vitit 2020 të bëjë po ashtu një punë të mirë.

**z.Reshat Mujota;** Unë jam anëtarë i Komitetit të Shëndetësisë, dhe ne si Komitet e kemi bërë raportin e punës dhe e kemi aprovuar, kështu që ati që i duhet ky raport ne mund të ja ofrojmë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë mendoj se raporti është i mirë, Kuvendi i ka arritur objektivat, mirëpo në raport nuk janë përmendur edhe sfidat, pastaj nuk janë përmendur edhe mungesa e drejtorëve në mbledhjet e Kuvendit dhe të Komiteteve. Sfidë është po ashtu edhe dalja e delegatëve nga mbledhja shumë shpesh, e cila duhet në një formë të rregullohet. Pastaj duhet të rregullohet edhe çështja e transmetimit të mbledhjeve sepse nuk po shihet mirë.

**z.Skender Hyseni;** Unë po dua të sqaroj si Kryesues i Komitetit për Shëndetësi, se ne si Komitet e kemi bërë raportin e punës dhe e kemi diskutuar por edhe e kemi aprovuar pavarësisht nga raporti i Kuvendit, ate mund ta sheh secili anëtar i Kuvendit.

**z.Naim Zejna;** Po e përshëndes Kryetarin që tani erdhi në mbledhje. Unë kisha thënë që në titullin e kësaj pike të rendit të ditës të thuhej "Raport i Punës së Kuvendit dhe trupave të KK për vitin 2019" Mbledhja e Kuvendit nuk po transmetohet unë po e shoh këtu. raportimi i Kryetarit në Kuvend e paraparë 4 herë gjatë vitit, unë e di që Kryetari vetëm 1 herë ka marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë konsideroj se sfidë është edhe mungesa e anëtarëve të Kuvendit pa arsye.

**z.Rexhep Gashi;** Në këtë raport nuk janë përfshirë disa trupa e që i kemi bërë disa rekomandime, e që mendoj se është dashur që të përfshihen. Po ashtu nuk është përfshi edhe çështja e transmetimit të mbledhjeve të Kuvendit në MAPL-ë e që ne e kemi ngritur si çështje.

**z.Besnik Seferi;** Unë jam i mendimit se te hyrja e Raportit fillimisht është dashur të paraqitet numri i anëtarëve të Kuvendit sipas subjekteve politike që i përfaqësojnë. Po ashtu është dashur që në raport të ceket edhe emri i anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë kaluar nëpër subjekte të tjera politike.

**z.Fehmi Hysenaj;** Komunat e tjera kanë të formuara edhe Komitetet Konsultative, e ne nuk kemi edhe kjo është dashur të përmendet në raport, sepse parashihet me Ligj.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Nuk e kemi pa të arsyeshme që ti përmendim numrin e anëtarëve të Kuvendit, edhe subjektet politike që u takojnë, sepse kjo është e njohur dhe dihet. Por e pranoj se është mirë që në raport të përmenden edhe trupat tjerë të Kuvendit, kjo do të jetë detyrë për raportet tjera të ardhshme. Unë e pranoj se sfida kryesore e Kuvendit është rikthimi i vendimeve për rishqyrtim nga ana e MAPL-së, ku i kemi pas 7 vendime të rikthyera, ne duhet të angazhohemi që ky numër të jetë sa më i vogël ose të mos kemi fare vendime që na rikthehen për rishqyrtim.

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.  
**\* Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Raportin e punës së Kuvendit të Komunës, dhe Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019, me vërejtjet.**

#### Pika 6

##### Raport i aktiviteteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Muhadin Halilit.

**z. Muhadin Halili, drejtor i DPP;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi raportin e aktiviteteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019, duke e lexuar, dhe në vazhdim tha se raportin e keni marrë me kohë në formë të shkruar dhe po besoj se e keni lexuar, unë i mirëpres pyetjet e juaja. (Shih dokumentin)

**z. Reshat Mujota;** Neve në fillim po na vinë raportet për projektet e realizuara pa emër e pa specifikacion, p.sh. te Projekti Nr.3 nuk po mund ta kuptojmë a është fjala për të njëjtin projekt apo po bëhet fjalë për ndonjë rrugë krejtësisht tjetër. u përmend mirëmbajtja me një shumë prej 4300€ çka është punuar me këto mjete, nuk ka shpjegim? Pastaj rregullimi i objekteve shkollore, pyetja është ku janë bërë këto rregullime? Nuk ka sqarim të mjaftueshëm për projektin e kanalizimit në fshatin Mollopolc në shumën mbi 60.000€. Sa i përket rrugës për te Kulla e Lirisë në Reçak, unë e di se atë rrugë e ka hapur KFOR-i nuk jam në dijeni se Komuna ka ndarë mjete për këtë rrugë. Sheshi i Komunës unë nuk kam pa deri tani diçka, edhe pse janë ndarë një shumë bukur e mirë e mjeteve financiare. Për sa i përket blerjes së mobileve unë po kërkoj me e ditë se për far mobile këtu po bëhet fjalë? Po ashtu po më intereson me ditë konkretisht numri i librave sa ka mundur me qenë. Transporti me pacient të hemodializës, tani kemi një ritenderim, dua ta di sa ka qenë përpara dhe sa është tani?

**z. Milot Deliu;** E falënderoj drejtorin për raportin, mua më kanë ra në sy kontratat që janë bërë për punë shtesë, pyetja ime është pse gabohet 13 herë që ka të bëj me punë shtesë në projekte kur e keni të paguar dhe kontraktuar një kompani projektuese për planifikimin e hartimin e projekteve. Dhe pyetja e dytë është si është e mundur që të njëjtës kompani i jepni punë edhe me nga 3 herë e më shumë?

**z. Fehmi Hysenaj;** E falënderoj drejtorin për raportin, në kuadër të listës së projekteve e shohim shumë qartë se shpërndarja e projekteve është bërë sipas militantëve partiakë. Në këtë raport mund të vërejmë se për disa operatorë ekonomik nuk është shënuar vendi se prej nga vjen ai operatorë, unë kërkoj që lista e operatorëve të jetë e kompletuar me të gjitha të dhënat e operatorëve ekonomik që kanë përfituar tenderët në komunën tonë. Na sqaroni pra pse duhet të ketë 2-3 operatorë ekonomik në një kontratë, atëherë cilit operatorë i paguhen mjetet financiare? unë kam pa këtu operatorë ekonomik i cili është regjistruar më 12 Maj 2019 dhe i njëjti ka fituar 2 projekte, na shpjegoni ju lutem si është e mundur një gjë e tillë? Në një projekt nuk thuhet se sa njësi janë kryer. Dua ta di se çka është dhe çka nënkuptoni me Objektiv Multi-funksional? Kemi edhe kompanin “Ardhmëria”, e cila ka marr projekte mjaft shumë nga Komuna, e që e kemi pa se është regjistruar si operator ekonomik edhe me një emër tjetër të firmës. Këto janë vërejtjet e mia.

**z. Besnik Seferi;** Mua më ka shqetësuar rasti i një kompanie e cila brenda 4viteve nga Komuna ka fituar 16 tender me një shumë mbi 2.000.000€, pyetja ime është pse qysh në fillimë nuk ka mundësi që punën me e marr një nënkontraktor i cili edhe realisht e kryen punën, por punën e merr një kompani e cila pastaj punën ja jep një nënkontraktori tjetër. Unë mendoj se pastaj realizimi i këtij projekti sigurisht që do të bie nga cilësia. Pse duhet me ja dhënë punën firmës “Ardhmëria” nëse ka mundësi që këtë punë me e kryer ndonjë firmë tjetër më e vogël. Unë po kërkoj që ne duhet me qenë sa më afër kompanive vendore e pastaj të shikohet më larg . Cilat kanë qenë punët shtesë për 13 projekte, unë mendoj se fajin për këtë e ka drejtorja e cila e ka neglizhuar realizimin e projekteve prandaj edhe duhet me dhënë përgjegjësi. Në raport e pamë se janë nda mjete për RZSH, për informim unë për vete shumë rrallë e kam pa një përfaqësues të tyre por edhe nuk kam pa asnjë lloj informate nga ta.

**z.Ruzhdi Jashari;** Në fakt tani po dalin gjërat që ne i kemi thënë më herët tani ato po i shohim në formë të shkruar. Unë jam që kushdo që ndeshet me ligjin duhet të përballlet me drejtësinë. Prokuroria e ka për detyrë me kryer punën e vet sipas ligjit. U përmend këtu disa herë firma “Ardhmëria” edhe kjo edhe të gjithë të tjerët duhet të punojnë plotësisht në përputhje me ligjin. Unë i ftoj të gjithë ata të cilët i vërejnë pa rregullsitë që ti raportojnë ato qoftë në prokurori ose në “ Kallxo.com”. Në raport duhet të shënohet saktë për secilin operatorë se sa punë ka marr si janë kryer ato punë. Po ashtu është mirë që të nxirret saktë një statistikë se sa punë ka marr firma “Ardhmëria”, gjatë kohës sa kam qenë unë Kryesues i Kuvendit. Është mirë me na dhënë sqarime edhe për 13 projektet e dyshimta për punë shtesë, që për ne është e pa pranueshme. Nëse për punë shtesë janë dhënë 48.000€ atëherë pyetja është se sa ka mundur të jetë vlera e përgjithshme e projektit, aj projekt është dashur të jetë milionësh.

**znj.Framire Ferati;** Faleminderit për raportin e detajuar. Ne e dimë që ligji i prokurimit duhet të respektohet . Ka një procedurë që po ashtu duhet të respektohet është një komision i cili e bënë vlerësimin e së cilës kompani konkurrese. Kjo ndoshta është edhe arsyeja se pse kompanitë e mira i fitojnë tenderët. Ato kanë të drejtë të marrin nënkontraktor. Sot aplikimet bëhen On-line që nga viti 2018 për këtë arsye unë konsideroj se gjithçka është transparente.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit për raportin mirë të sistemuar, ky është një raport i rrjedhjes së parasë publike. Për 13 projekte po bëhen punë shtesë kjo nuk bënë të ndodhë. Unë mund të numëroj disa projekte konkrete të dyshimta. (Në vazhdim lexoj nga raporti disa projekte, dhe bëri krahasime).

**z.Shefki Dauti;** Faleminderit për raportin, u tha mjaftë shumë, e ndoshta edhe me arsye, sepse nëse e shohim projektin e asfaltimit të rrugës deri te Kulla e Lirisë është e prishur në mas të madhe, unë nuk e di kush e ka punuar atë asfalt por atu shihet se nuk ka aspak cilësi. Trotuarin për Petrovë, unë po dua me ditë se pse po len me kuptuar se thjeshtë menaxheri i projektit veç e nënshkruan atë, as qe e dinë se çka po ndodhë në teren. Nëse kontraktohet asfaltimi i një rruge me gjerësi prej 4m, pse duhet ajo rrugë të bëhet me gjerësi 2.5 m. Pse po ndodhë në Komunën tonë që një kompani i merr krejt projektet kryesore, e merr mazën dhe për tjerat i merr ndonjë kompani tjetër. Nëse e shohim tenderin e pastrimit të rrugëve nga bora, kur bien bor për kompaninë thuhet se nuk po ka kapacitet të mjaftueshëm, e në shumicën e rasteve kompania i merr paret pa kryer ndonjë punë, kështu pra është krijuar një praktike jo e mirë. Unë mendoj se pikërisht këtu duhet të kemi një llogaridhënie më të madhe.

**z.Naim Zejna;** Pajtohem plotësisht me atë që e thanë kolegët e mijë. Është shume brengosëse fakti i dhënë së punës shtesë, me këtë po dojë me favorizua dhe me i ndihmuar dikujt. Po ashtu shuma që është dhënë për projektet shtesë është mjaft brengosëse. Rreth gjysmë milioni i ka marr kompania “Ardhmëria”, nga tenderët që ja ka dhënë Komuna. Unë nuk dua ta zgjati më shumë por po theksoj se edhe cilësia e projekteve është në nivel të ulët.

**z.Herolind Selmani;** Faleminderit për raportin shumicën e vërejtjeve i tanë kolegët për të cilat edhe unë pajtohem. Nëse i marrim dhe i krahasojmë projektet që janë paraqitur në këtë raport ato bien ndesh me raportin e Kuvendit si psh. te shtrimi i rrugëve pastaj te stadioni i qytetit e te disa projekte të tjera. Unë njohë operator ekonomik që nuk kanë asgjë në shtëpinë e tyre e i cili ka fituar tender në vlerë prej 20.000 €, si është e mundur që të ketë sukses një projekt i tillë. Unë kam një pyetje për drejtorin se firma “Dashnim Jashari”, a është e njëjta firmë me “Ardhmëria”, sepse kjo çështje realisht për mua është mjaft konfuze?

**z.Muhadin Halili, drejtor i DPP;** Unë po dua të sqaroj se ne në drejtori vetëm sa i udhëheqim procedurat e prokurimit, nuk bëjmë punë të tjera të far do qofshim ato, e aq më pak të ndërhyrje sose diçka tjetër. Ne jemi të obliguar që vetëm ta zbatojmë ligjin e prokurimit. Për sa i përket detajeve për projektet, pastaj për mbikëqyrjen e projekteve, informatat duhet të kërkohen në drejtori tjera. Kontratat të gjitha janë të specifikuar dhe janë të publikuar në ueb faqen e Komunës. Duhet të dallohet mirë vlera e parashikuar e kontratave me vlerën e kontratave të nënshkruara. Sa i përket punës shtesë arsyetimin e këtyre punëve e jep planifikuesi dhe vjen për prokurim , ne jemi të obliguar sipas ligjit që të kemi së paku 3 oferta. Te projektet me 3 operator ligji e përcakton saktë se cilit prej operatorëve duhet me ja paguar mjetet. Në vazhdim ky foli për proceduar e prokurimit si dhe për komisionin e



vlerësimit. U përmend edhe një rast i cili është raportuar te kallxo.com, sa i përket këtij rasti unë mund të them se aty ka shumë të pa vërteta.

**z.Reshat Mujota;** Faleminderit për sqarimin, unë i kam pa kontratat që janë publike. Puna në teren len për të dëshiruar shumë, dhe kjo ka rëndësi të madhe. Projekti i parqeve në fshatin Mollopolc është në gjendje tmerruese. Unë po çuditë se si mund të ketë punë shtesë në një projekt ku atje fare nuk është kryer puna.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë po ju pyes a kërkohet referenca për një kompani ofertuese, nëse po atëherë si është e mundur që një biznes i cili është regjistruar në muajin Maj të fitoj tender kur dihet se ai nuk mund të ketë referenca . Pyetja tjetër është prej nga është ndërmarrja “Blendi”?

**z.Shefki Dauti;** E falënderoj drejtorin për sqarimin por unë po kërkoj që karshi publikimit të kontratave të publikohen edhe paramasa dhe paralogaria e projektit.

**z.Ruzhdi Jashari;** Shumë herë ne të gjithë kemi kërkuar specifikimin e projekteve, pse nuk po e bëni kur dihet se tani kushtet ekzistojnë, e kemi emërtimin e rrugëve. Janë dhënë 250.000€ për dru ndërkaq që në anën tjetër shkollat nuk kanë dru, si është e mundur kjo, janë 7 kërkesa për qasje në dokumente publike, a ka mundësi me ditë kush janë këto 7 kërkesa? në raport është përmend veshmbathje, a mund ta dim se për këndë janë parapa këto veshmbathje?

**z.Muhadin Halili, drejtor i DPP;** Çështja e furnizimit me veshmbathje, siç mund ta dini kemi disa institucione që duhet ti furnizojmë me uniforma siç është rasti në QKMF, QPS, te Zjarrfiksat etj. Vlerësimi i operatoreve për projekte bëhet në bazë të kriterëve po ashtu edhe në bazë të referencave. Firma “Blendi” është nga Prishtina. Sa i përket druve është një kontratë 3 vjeçare ( Kontratë Kornizë)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 6 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Raportin e aktiviteteve të Zyrës së Prokurimit gjatë vitit 2019.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Dha 30 minuta Pauzë, në ora 12.45h.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Vazhdojmë me mbledhjen në ora 13.29h.

#### Pika 7

##### Informatë për Obligimet e Komunës nga Agjenda Evropiane, (MSA)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ekrem Reçica.

**z.Ekrem Reçica, zyrat për integritet evropiane;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi këtë raport duke e lexuar në pikat kryesore. Në vazhdim tha se kemi 4 dokumente të cilat ne u a kemi dërguar me kohë dhe po besoj se i keni lexuar. Meqenëse është një dokument shumë voluminoz unë nuk do ta zgjas shumë por po i mirë pres pyetjet dhe sugjerimet e juaja ( Shih dokumentin)

**z.Naim Zejna;** E përshëndes zyrtarin për raportin e detajuar. Ky i përmendi 146 obligime të Komunës që dalin nga ky dokument. Unë po e pyes zyrtarin se ku qëndrojmë ne si Komunë në raport me Komunat tjera, kjo me qellim që ne ta grisim performancën?

**znj.Fatmire Ferati;** Cilat janë kriteret që janë plotësuar plotësisht. Shifra prej 64% që u përmend a ishte për nivelin lokal apo për atë qendror?

**z.Ruzhdi Jashari;** Faleminderit për raportin. Raporti është obligativ dhe është tepër i rëndësishëm. Unë kam pas rastin me qenë në këshillin koordinues në nivel qendror. Këtu kemi aktivitete konkrete të cilat duhet të përmbushen. Aspekti kryesor i kësaj është luftimi i korrupsionit dhe nepotizmit ku kërkohen shifra konkrete nëse janë përmbushur kushtet. Po ashtu duhet të kemi planin për përmbushjen e kriterëve të marrëveshjes për Asociim e Stabilizim. Kjo marrëveshje është shume e gjerë është publike dhe mundeni me e pa. Është mirë që neve me na i dërguar materialet ku është e përfshirë Shtimja e jo me na dërguar material prej 500 faqeve. A po doni ju pozita një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit për çështjen e prokurimit ne jemi të gatshëm . Ne kemi me ta dhënë mbështetjen sa herë që bëhet fjalë për Kosovën.

**znj. Arbresha Sylja;** Faleminderit për raportin e kompletuar , sepse kur raporti po vjen komplet po thoin pse po na vinë raportet kaq voluminoze. Në raport ka përgjigjeje për se cilën pyetje konkrete, nuk është mirë të bëhen këtu politika populiste. Unë kam një vërejtje se te niveli i vendim marrjes femrat ende nuk janë të barabarta.

**z.Ekrem Reçica, zyrat për integritet evropiane;** Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është prej 750 faqeve . Te përqindjet e realizimeve të obligimeve që kanë Komunitatet ka qenë me 62% në raport me nivelin qendror që ka qenë me 50%. Komunitatet dmth. kemi ecë përpara. Tani nuk mjafton më vetëm përmbushja e obligimit ligjor në raportin e progresit po kërkohet gjithnjë e më shumë edhe cilësia. Jam dakord që ta bëjmë bashkë dhe ta përkthejmë në projekte konkrete. Vërejtjet dhe sugjerimet janë të mirë se ardhura. Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve nga viti i kaluar ka filluar të zbatohet, është risi shumë e madhe ku garantohen të dhënat personale të sinjalizuesit, mirëpo ne po presim edhe dokumentet plotësuese. Dokumenti përmban aktivitete ku ka për qëllim që të ndaj detyrat te secili zyrtar i Komunitetit. Unë nuk i krijoj të dhënat por ato i procedoj ashtu siç i kam marr nga zyrtarët. Aspekti financiar duhet të sigurohet dhe për sa i përket trajnimeve, parat janë por po kërkohet profesionalizëm dhe cilësi.

#### Pika 8

##### Informatë e përgjithshme nga DKRS-së

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Lumni Amrushit.

**z.Lumni Amrushit, drejtori i DKRS;** Përshëndetje për të gjithë, informatën e kam përgatitur në formë të shkruar, dhe e keni marrë me kohë. Aktivitetet i kemi organizuar ashtu siç ka qenë e planifikuar. Na brengos pak fakti se nuk ka të rinj të interesuar për aktivitete sa ne po kemi dëshirë. (Shih dokumentin) Rezultate të mira kemi shënuar në sport por në fushën e sporteve individuale. Kemi pas përkrahje për bibliotekën ku edhe ka rezultuar me rritjen e numrit të lexuesve. Unë nuk do ta zgjati por i mirëpres pyetjet e juaja.

**z.Muhamet Ademaj;** E falënderoj drejtorin për informatën, rinia kohën e lirë duhet që ta kalojnë në aktivitete sportive e jo nëpër kafiteri. Kam një pyetje për drejtorin se a punon Palestra Sportive, a ka rrymë dhe a ka nxehje a jo?

**z.Ruzhdi Jashari;** E falënderoj drejtorin për informatën, kjo ka kuptim pak më të gjerë se sa që po paraqitet, është përmendur disa herë por nuk është e tepërt që të përsëritet shumë herë çështja e përdorimit të substancave narkotike nëpër shkollë, kjo është çështja më brengosëse që duhet patjetër të merremi të gjithë ne. detyra e Drejtorisë është që sa më shumë të tërheq të rinj nga rruga dhe ti orientoj te leximi te sporti dhe aktivitete tjera shkollore. Për shënimin e përvjetorëve shkojnë e i marrin firmat e komunave të tjera e u japin nga 7-8 mijë euro. Çështja e Muzeut, e di që nuk është bërë mjaft, eksponatet një ditë do të shkatërrohen. E falënderoj Lulzim Sahitin që ka qenë iniciues për përkrahjen e Muzeut. Aty 3 ekzemplarë janë të punimeve të mija. unë mendoj se duhet të ketë të ndarë një shumë të caktuar të mjeteve financiare për sa i përket aspektit menagjerial.

**z.Skender Hyseni;** E falënderoj drejtorin për informatën, po kyçem në diskutim për sa i përket Klubit Futbollistik "Vjosa" me sa e di unë në këtë klub nuk ka rezultate të mira. Unë e kam vërejtë se te ky klub ka një lloj familjarizmi, kështu që ai klub në atë qasje nuk ka mundësi me shkuar përpara. Unë mendoj se duhet patjetër me pas një përkrahje të mirë për ta drejtuar këtë klub.

**z.Fehmi Hysenaj;** E falënderoj drejtorin për informatën, jemi për të dhënë vërejtjet tona ku ka nevojë, unë jam i mendimit se kultura është në një krizë të madhe. Më herët edhe në mungesë të mjeteve financiare kemi pas dy shoqata kulturore që e kanë dridh krejt Kosovën. Sa i përket ditës së Dëshmorëve, është për të ardhur keq mënyra se si është organizuar sepse ne si delegat as ftesa nuk kemi pas. Brenda vitit asnjë lloj festivali nuk ka pas. Sa i përket shfaqjeve, mua më ka rastisur fati që në një shfaqje meni kam dalë nga salla për shkak të ftohtit. te sporti vërehen disa lëvizje pozitive, është inkurajues fakti se po punohet me moshat e reja. Sektori i rinisë nuk është mirë fare këtë besoj e keni vërejt të gjithë.

**znj.Arbresha Sylaj;** E falënderoj drejtorin për informatën, karshi mundësive janë aktivitete maksimale, dëshirat janë të mëdha, mirëpo ne i dimë mirë mundësitë që i kemi. Kam një pyetje për drejtorin, a ju ka shkuar mendja për me e organizuar një takim me bizneset konkretisht me Klubin e Biznesit në Shtime, për me biseduar me ta për sa i përket përkrahjes së sportit në Komunën tonë?

**znj.Marigona Pajaziti;** E falënderoj drejtorin për informatën, unë pata një pyetje për drejtorin se kur mendohet me u lëshuar në përdorim Biblioteka?

**z.Lumni Amrushi, drejtori i DKRS;** Te Palestra Sportive disa herë jam përgjigjur, që çështja e furnizimit me rrymë ka qenë neglizhencë e KEDS-it. Dje kemi bërë sërish kërkesën për kyçje. Te shkolla profesionale për pyetjen e Muhametit nuk kam përgjigje. Te Ruzhdi Jashari edhe ne i kemi të njëjtat shqetësime, mos ta banalizojmë sepse i kemi mundësitë e njëjta. Nuk ka ndryshime në buxhetin e drejtorisë. Ka ide për projekte konkrete. Nuk është më koha e punës vullnetare. Nuk është më koha e punës vullnetare. Te subvencionimi i klubeve sportive asnjë kërkesë nuk është refuzuar, i kemi dhënë mundësi secilës. Sa i përket bibliotekës së hapur, ka qenë një aktivitet vullnetar që e ka bërë një kompani private. Korniza e saj është ende aty, mirëpo librat nuk janë. Arbëresha e dha një propozim për me e taku klubin e biznesit aktivitet të cilin e kemi të paraparë me planin e punës. Te Skenderi lidhur me klubin futbollistik “Vjosa”, mund të them se tani e ka një kryesi të re që një muaj e gjysmë, kemi vërejt se ata po bëjnë një punë të mirë që nuk ka ekzistuar deri tani. Në këto momente gjithçka është transparente. Nuk qëndrojnë ato që thotë se aty ka familjarizim. Sa i përket bibliotekës dhe arkivit kemi pas mbështetje nga ministria, mirëpo mbështetje nuk kemi gjetur sa i përket stadionit të futbollit.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Shpalli të mbyllur këtë pikë.

#### Pika 9

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021 (Pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe fjalën ja dha Halil Halilit.

**z.Halil Halili, drejtor i DSHP;** Përshëndetje, sipas vendimit të Kuvendit plani ka qenë në diskutim publikë, i cili është organizuar që nga data 10.01.2020. Diskutimi publikë është mbajtur por nuk kemi të kënaqur me numrin e pjesëmarrësve. Nuk kemi pas ndonjë propozim konkret prandaj unë ju ftoj që ta votoni këtë plan.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 12 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.**

#### Pika 10

Propozim-Vendim për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë në Shtime. (Pikë shtesë)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Lexoi Propozim-Vendim për dhënien e Veturës komunale, Stacionit të Policisë, dhe hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arbresha Sylaj;** Për këtë pikë ne kemi diskutuar edhe në KPF, dhe e kemi përkrahur, sepse konsideroi se është e vlefshme dhe e nevojshme për policinë. Konstatimi se po i japim një veturë të vjetër dhe jashtë përdorimit nuk qëndron. Është thënë se kjo bile është ndër veturat më të mira.

**z.Fehmi Hysenaj;** Unë po mendoj se Komuna jonë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës është ranguar në nivel me Komunën e Ranillikut, ky është problemi. Policia kanë një vijë tjetër të furnizimit, unë mendoj se në nivelin qendror ka mjaft vetura të cilat mund ti ja japin Policisë. Unë jam që kjo veturë ti jepet në shërbim drejtorisë së arsimit ose QPS-së.

**z.Milot Deliu;** Unë e mbështesë këtë propozim, por po mendoj se problemi është te regjistrimi përkatësisht te sigurimi i automjetit sepse mund të kemi ndonjë problem me sigurimin e automjetit në rast të ndodhjes së ndonjë fatkeqësie të mundshme.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë kam thënë edhe më herët se QPS-ja nuk ka automjet të përshtatshëm për kryerjen e punëve, punëtorëve u rrezikohet edhe jeta me automjet të vjetër, prandaj unë po kërkoj që ky automjet ti jepet QPS-së.

**z.Muhamet Ademaj;** Edhe unë jam që vetura ti jepet Policisë.

**z.Naim Zejna;** Edhe unë i ndaj shqetësimet e njëjta sikurse që i thanë kolegët para meje. Çështja e sigurimit të automjetit është përgjegjësi e nivelit qendror mos të na del që nesër për këtë arsye duhet ta blejmë një veturë të re.

**z.Ruzhdi Jashari;** Aspekti i sigurimit të automjetit i takon Kryetarit të Komunës, për sa i përket QPS-së unë mendoj se ka mundësi me pas shërbime kontraktuale, ndërsa Policia nuk e ka këtë mundësi. Ata kanë thënë se janë ngushtë dhe janë keq për një veturë, ne duhet tu dalim në ndihmë. E dimë që këto vetura e dojnë një mirëmbajtje.

**z. Labinit Beqa, drejtor i DSHMS;** Përshëndetje, tani sa e lexova në rregullore se ka mundësi me pas një makinë me qera.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, me 11 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi t’i jep Veturën e Administratës Komunale, të Tipit: Golf 5, 2.0, Automatik, ngjyra e zezë, me 4 dyer, numri i Targave: 05Z-05-22, me regjistrim deri më datën: 28.06.2020 Stacionit të Policisë në Shtime.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 14.44h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj

